



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 052/01-65488 dt. 22/12/2022

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr.04/L-027 për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera si dhe Rregullores (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të aprovoi këtë:

POPOZIM VENDIM

Për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Neni 1

Me këtë propozim vendim në përputhje me nenin 31 paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit të Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi miratohet vlerësimi i dëmeve në shumën totale prej 108,983 euro dhe atë 59.630.02 euro për dëme në ekonomi Familjare dhe 43.120 euro për dëme në Biznese, dhe për dëme në Bujqësi 6232.81,00

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjente

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe verifikimit nga ana e Komisionit Qendrorë për vlerësimin e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Raporti i Komisionit Komunal përfundimtarë për vlerësimin e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera është një dokument i hartuar në përputhje me ligjin Nr.04/-L-027 për mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera dhe Rregulloren (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera e cila i obligon komunat që të themelojnë komisionet për vlerësimin e këtyre dëmeve përmes së cilit është bërë vlerësimi i tyre me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira materiale e shprehur në vlerë monetare të nevojshme për kthimin e të mirave materiale të dëmtuara apo shkatërruara në gjendjen e tyre paraprake, përkatësisht në vlerën e cila është e nevojshme që këto të mira materiale të blihen apo riparohen. .

Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzoj në kuvendin komunal për shqyrtim dhe miratim ku edhe pas miratimit i njëjti në afatin prej 15 ditëve dorëzohet tek Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe një kopje Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera i cili më pastaj konstaton për korrektësinë apo për mangësitë eventuale të tij .

Andaj duke pasur parasysh këtë si dhe rekomandimet e Komisionit Qendrorë të vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera lidhur me procedurën e shqyrtimit të raporteve të komunave për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe ndikimi i fatkeqësive tjera propozon që brenda afatit ligjorë dhe në përputhje me nenin 31 paragrafi 1.1 I rregullores (QRK) (QRK) Nr.17.2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera të miratoj këtë propozim vendim .